

V E N D I M
Nr.645, datë 20.11.1995

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.351, DATË
30.6.1993 “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR PASUNIVERSITAR DHE KLASIFIKIMIN E
PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.177,
DATË 25.4.1994**

Me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.351, datë 30.6.1993, ndryshuar me vendimin nr.177, datë 25.4.1994, pas pikës 7.3.a.2 shtohet pika 7.3. a.2.1 me këtë përmbajtje:

“Me propozim të institucioneve që kanë të drejtën përkatëse, Komisioni i Kualifikimit Shkencor merr në shqyrtim dhe jep titullin “Profesor” për persona me veprimtari të gjatë e të mirënjohur cilësore në fushën e studimeve shqiptare, të lëvrimin të gjuhës shqipe, të studimit të historisë së popullit shqiptar, të kulturës, letërsisë, artit, si dhe në fusha të tjera të shkencës, të cilët gjatë kohës së diktaturës janë burgosur, internuar dhe mënjeluar sistematikisht nga pjesëmarrja aktive në veprimtari të zyrtare kërkimore-shkencore dhe janë penguar për marrjen e gradave e të titujve shkencorë.

Kjo pikë do të zbatohet gjer më 31 dhjetor 1995".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi